

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6732
E shtunë, 15 tetor 2022
çmimi 0.40 €

BE-ja kërcënon Serbinë me pezullim të liberalizimit të vizave



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYETARI I ALEANCËS PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK), RAMUSH HARDINAJ, KA KËRKUAR QË KRYEMINISTRI ALBIN KURTI TË RAPORTOJË NË KUVEND PËR DIALOGUN ME SERBINË

HARADINAJ KËRKON QË KURTI TË JAPË SQARIME PËR DOKUMENTIN FRANKO-GJERMAN



Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Hardinaj, ka kërkuar të premtën nga kryeministri Albin Kurti që të raportojë në Kuvend për dialogun Kosovë - Serbi, veçanërisht për dokumentin franko-

gjerman që është duke qarkulluar si ide kohën e fundit. Ish-kryeministri Haradinaj ka thënë se në procesin e dialogut Kosovë - Serbi ka vetëm një dokument: ai amerikano-evropian

OPINION

KUSHTËZIM I VIZAVE NGA FRANCA DHUNON LIBERTE, EGALITE DHE FRATERNITE! F. 6

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



MËSIMI DUAL PO PILOTOHET SUKSESSHËM NË KOSOVË F. 7

FJALIMI I RAMËS NË STRASBURG, BERISHA: I FUTI THIKËN KOSOVËS DHE MBROJTI BEOGRADIN F. 3

EKONOMI



QEVERIA SHKURTON DITËT E PUSHIMIT NGA PËRVOJA E PUNËS PËR ZYRTARËT PUBLIKË F. 8

SPORT



ÇEKU: DO TË NDËRTOHEN SHATËTË PALESTRA TË XHUDOS NË KOSOVË F. 10

TAKIMI PDK - LIBSEEN, MIRATOHET DEKLARATA PËR MBËSHETJE TË LIBERALIZIMIT TË VIZAVE DHE STATUSIT KANDIDAT PËR KOSOVËN



OPOZITA KËRKON SHPJEGIME PËR VIZAT

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja kërcënon Serbinë me pezullim të liberalizimit të vizave

BRUKSEL, 14 TETOR - Komisionarja për Punë të Brendshme e Bllokut evropian, Ylva Johanson, tha se nuk përjashtohet mundësia që Bashkimi Evropian ta pezullojë liberalizimin e vizave për Serbinë për shkak të rritjes së madhe të emigrantëve që shkojnë në BE përmes Serbisë. Për rritjen e numrit të emigrantëve përmes asaj që njihet si "Rruga Ballkanike" janë duke diskutuar ministrat e brendshëm të shteteve të BE-së në Luksemburg. Në rastin e Serbisë, si problem serioz theksohet mospërshatja e regjimit të vizave me atë të BE-së. Serbia u lejon hyrjen pa viza në territorin e saj qytetarëve të disa shteteve të treta të cilët më pas vazhdojnë udhëtimin drejt territorit të BE-së. "Shpresoj se Serbia dhe partnerët e tjerë nga Ballkani Perëndimor do të

bashkëpunojnë me ne dhe do ta përshtatin regjimin e tyre të vizave me atë të BE-së. Por, në këtë moment kjo nuk është diçka që mund të përjashtohet", tha komisionarja Johanson në prag të takimit të ministrave të Brendshëm të BE-së.

Ajo nënvizoi në veçanti faktin se qytetarët nga Kuba, Burundi, India dhe vendet e tjera vijnë në numër më të madh në BE përmes Ballkanit, dhe shtoi se me këtë çështje duhet të merren të gjithë. "Ajo që bën Komisioni Evropian, e në këtë drejtim do të punojë edhe më shumë, është që mesazhi të arrijë deri te partnerët tanë në Ballkanin Perëndimor se na duhet përshtatje e regjimit të vizave, në mënyrë që të ndalet vala e atyre që vijnë pa viza në Ballkan dhe vazhdojnë drejt BE-së", tha komisionarja Johanson.



Për çështjen e rritjes së numrit të migrantëve që shkojnë në BE përmes Ballkanit Perëndimor, foli edhe ministri i Brendshëm i Çekisë, Vit Rakushan.

Vendi i tij aktualisht po kryeson Presidencën e BE-së. "Po shoh numër gjithnjë e më të madh të emigrantëve të cilët në BE po vijnë përmes 'Rrugës së

Ballkanit Perëndimor' dhe ne po i shohim pasojat në secilin kënd të BE-së", tha Rakushan. Ministri çek, po ashtu, tregoi se në nëntë muajt e parë të këtij viti, në BE përmes Ballkanit Perëndimor, kanë shkuar mbi 106 emigrantë ilegalë.

Bashkimi Evropian mund t'i aktivizojë mekanizmat e pezullimit të vizave në rast se vlerëson se ekziston rrezik nga emigrimi masiv.

Ndryshe, Austria, Hungaria dhe Serbia së bashku do ta forcojnë kontrollin kufitar me Maqedoninë e Veriut për ta ndaluar rritjen e numrit të emigrantëve drejt Bashkimit Evropian, u tha pas një takimi të përfaqësuesve të tri vendeve më 6 tetor në Beograd. Gjithashtu, është konfirmuar se një nga masat e para do të jetë përshtatja e politikës së vizave të Serbisë me BE-në.

Serbia ka fituar liberalizimin e

Rusia ua ndalon hyrjen disa zyrtarëve të lartë të Malit të Zi



MOSKË, 14 TETOR - Rusia ua ka ndaluar hyrjen ministrit të Jashtëm të Malit të Zi, Ranko Krivokapiq, atij të Brendshëm, Rashko Konjeviq, dhe ish-drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Sigurisë, Savo Kentera.

Njoftimi u bë publik nga Ministria e Jashtme e Rusisë më 14 tetor përmes një shkrese që i dërgoi Ambasadës së Malit të Zi në Federatën Ruse. "Kjo masë është në përgjigje të një tjetër vendimi armiqësor të palës së Malit të Zi në shtator të këtij viti, kur shpalli 'non grata' diplomatë

të Ambasadës Ruse në Podgoricë", u tha në njoftimin e Ministrisë së Jashtme ruse.

Në fund të shtatorit, në një aksion Agjencisë Kombëtare të Sigurisë së Malit të Zi dhe Zyrës së Prokurorisë Speciale, u zbulua një rrjet i agjentëve rusë të inteligjencës që vepronin në Malin e Zi.

Gjashtë diplomatë rusë u dëbuan dhe 28 shtetasve të huaj iu ndalua hyrja në Mal të Zi. Siç deklaruan autoritetet, vendimi për dënim nga Mali i Zi u mor për shkak të aktiviteteve që ishin në "kundërshtim me Konventën

e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike".

Raportet diplomatike midis Malit të Zi dhe Rusisë janë përkeqësuar që nga viti 2014, kur Podgorica mbështeti sanksionet e Bashkimit Evropian ndaj Rusisë për shkak të aneksimit të paligjshëm të Gadishullit ukrainas të Krimesë. Mali i Zi iu bashkua sanksioneve perëndimore ndaj Moskës, pasi kjo e fundit nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 24 shkurt. Pas kësaj, Rusia e futi Malin e Zi në listën e "shteteve armiqësore".

Turqia kritikohet për ligjin kundër informacioneve të rreme

ANKARA, 14 TETOR - Ligjvënësit në Turqi kanë miratuar një ligj të ri për mediet, që parasheh dënim prej tre vjetësh burgim për këdo që publikon "informacione të rreme". Ky legjislacion është kritikuar nga grupet e të drejtave të njeriut, që thonë se kufizon lirinë e shprehjes para se shteti t'i mbajë zgjedhjet e reja vitin e kaluar. Ligji, që u miratua mbrëmjen e 13 tetorit, u propozua nga partia në pushtet e presidentit Rexhep Tajip Erdogan dhe aleatët e tij ultra-nacionalistë në Parlament. Miratimi i këtij legjislacioni erdhi vetëm një ditë pasi Asambleja Parlamentare e

Këshillit të Evropës kërkoi nga autoritetet në Ankara që të mos e miratojnë të njëjtin.

Sipas ligjit, gazetarët dhe përdoruesit e medieve sociale të cilët postojnë informacione që autoritetet i konsiderojnë të rreme lidhur me "sigurinë e brendshme dhe të jashtme të shtetit, rendit publik apo shëndetit publik", mund të dënohen deri me tre vjet burgim.

Definicioni i paqartë se çfarë mund të cilësohet "lajm i rremë" rriti shqetësimet e opozitës dhe aktivistëve të të drejtave të njeriut. "Sot është një ditë tjetër e errët për lirinë e shprehjes në

platforma online dhe për lirinë e shtypit në Turqi", tha Güney Yıldiz, hulumtues në Amnesty International. "Duke pasur parasysh rritjen e kontrollit ndaj medieve nga qeveria në këto vitet e fundit, masat e reja u mundësojnë atyre që të censurojnë më tej dhe të heshtin zërat kritikë, para se Turqia t'i mbajë zgjedhjet e reja, nën pretendimet për luftimin e dezinformimit", shtoi Yıldiz.

Erdogan, i cili i ka quajtur mediet sociale kërcënim për demokracinë, pritet që të përballet me sfida të fortë ndaj qeverisjes së tij 20-vjeçare në zgjedhjet e vitit të ardhshëm.



Takimi PDK - LIBSEEN, miratohet deklarata për mbështetje të liberalizimit të vizave dhe statusit kandidat për Kosovën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka qenë nikoqir i takimit të Rrjetit të Partive Liberale të Evropës Juglindore (LIBSEEN), pas anëtarësimit të PDK-së në këtë rrjet në muajin maj të këtij viti.

Në Prishtinë, në takimin e Komitetit Drejtues të LIBSEEN, pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e partive kryesore liberale të Kroacisë, të Sllovenisë, të Maqedonisë së Veriut, të Malit të Zi etj.

Në këtë takim, i cili mbledhi partitë e Evropës Juglindore të cilat ndajnë vlera liberale dhe demokratike, me propozimin e PDK-së si anëtare, Komiteti ka miratuar Deklaratën

për Mbështetjen e Liberalizimit të Vizave dhe Statusit Kandidat për Kosovën. "Pasi ka hyrë në fazën vendimtare të vendimmarrjes, LIBSEEN bën thirrje për miratimin urgjent nga Këshilli i Evropës të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës në përputhje me propozimin e Komisionit Evropian të datës 18 korrik 2018, bazuar në përmbushjen e të gjitha 95 kritereve. Kujtojmë qëndrimin e Parlamentit Evropian në favor të liberalizimit të vizave të 28 marsit 2019 dhe thirrjet pasuese në rezolutat që kanë të bëjnë me Kosovën", thuhet në Deklaratën e miratuar nga LIBSEEN në Prishtinë.

Më tej, LIBSEEN konsideron se heqja e barrës financiare dhe administrative të vizave do të

ndikojë ndjeshëm dhe drejtpërdrejt në kontaktin në mes të njerëzve dhe kështu do të nxisë më shumë shkëmbime akademike, kulturore dhe biznesore ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se kjo Deklaratë, e miratuar sot në Prishtinë nga Rrjeti i Partive Liberale të Evropës Juglindore, është e rëndësishme dhe ndihmuese për përmblylljen e procesit të tejzgjatur, por të merituar, për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës. "Sot miratua një deklaratë të përbashkët, e cila adreson perspektivën evropiane të Kosovës, duke përfshirë edhe mbështetjen absolute për liberalizimin e vizave, por edhe aplikimin e Kosovës për ta

marrë statusin e kandidatit. Kisha kënaqësinë që bashkë me koordinatoren zotëri Jakiç nga Sllovenia të diskutojmë edhe për tema që lidhen me shtete të veçanta të rajonit, duke përfunduar edhe me mbështetjen e tyre të madhe për procesin e anëtarësimit të Kosovës në partinë Aleanca Liberale e Demokratëve të Evropës, që presim të ndodhë gjatë këtij viti", ka thënë Kryetari Krasniqi.

Kryesuesi i LIBSEEN, Roman Jakiç nga Sllovenia, ish-eurodeputet dhe ish-ministër i Mbrojtjes i Sllovenisë, ka thënë se përmes kësaj deklarate synohet t'u dërgohet një mesazh i qartë organeve vendimmarrëse të Bashkimit Evropian që urgjentisht të veprojnë për liberalizimin e vizave dhe dhënien e statusit kandidat për Kosovën. "Është me të

vërtetë e turpshme që Evropa të mos e realizojë atë që i kemi premtuar popullit të Kosovës dhe, së dyti, kemi diskutuar që Kosova të aplikojë për statusin e kandidatit në Bashkimin Evropian. Pas ditës së djeshme, kur Bosnja-Hercegovina mori, le të themi, rekomandimin pozitiv të Komisionit Evropian, drejtuar Këshillit për këtë, ne nuk duam ta shohim vetëm shtetin e Kosovës jashtë këtij procesi. Pra, mendoj se Kosova mund të fillojë, duhet të fillojë, gjithsesi duhet ta fillojë edhe procesin e anëtarësimit dhe të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian", ka theksuar Jakiç. PDK-ja u anëtarësua me të drejta të plota në Rrjetin e Partive Liberale të Evropës Juglindore më 14 maj të vitit 2022 në takimin e Komitetit Drejtues të mbajtur në Sarajevë.



Fjalimi i Ramës në Strasburg, Berisha: I futi thikën Kosovës dhe mbrojti Beogradin

TIRANË, 14 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike në Shqipëri, Sali Berisha, në një konferencë me gazetarë të premtën, e ka komentuar fjalimin e kryeministrit Edi Rama në Asamblesën e Përgjithshme të Këshillit të Evropës, ku ai ka folur edhe për Kosovën.

Berisha ka thënë se Rama me këtë fjalim ia futi thikën Kosovës dhe e mbrojti Beogradin. "Rama në Strasburg i futi thikën Kosovës, sepse në momentin kur kishte nevojë për një lobim pozitiv për anëtarësimin në Këshillin e Evropës, ai në sallën e këtij tempulli lëshoi lumë sharjesh dhe akuzash ndaj tij të padëguara në atë sallë në



tërë historinë e saj të ekzistencës. Uroj dhe i bëj thirrje Këshillit të Evropës dhe Asamblesës së

Parlamentare të votojnë për Kosovën si anëtare e saj më të re dhe të mos ndikohen nga retorika

arkaike e një njeriu që është në mision kundër kombit të vet. Rama i futi thikën Kosovës sepse me retorikën e tij mbrojti dhe mbuloi Beogradin, prokurorin e krimeve të luftës për Serbinë si burimin absolut kryesor të të gjitha trillimeve të raportit të Dick Martyt. Edi Rama në Strasburg i futi thikë pas shpine Kosovës, sepse përdori presionin e hapur ndaj Gjykatës së Hagës. Reagimi i Ramës zgjoi neveri dhe dënim të ashpër në komunitetin ndërkombëtar, përfshirë këtu personalitet që kanë lobuar për lirimin e udhëheqjes politike të Kosovës", ka thënë Berisha.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi

Rama, i është drejtuar të mërkurën Këshillit të Evropës për ta kërkuar rishikimin e raportit të Dick Martyt dhe për t'i shpallur të pabaza akuzat e tij për trafikim të organeve njerëzore gjatë Luftës Çlirimtare në Kosovë. Gjatë fjalës së tij Rama i ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e raportit duke i analizuar të gjitha pikat e tij. Ai ka thënë se ky raport është një fantazi e pastër e fabrikuar në Kremlin dhe i sjell në Këshillin e Evropës. "Ju bëj thirrje t'i rrëzoni akuzat kundër Kosovës. Ju bëj thirrje ta pranoni kërkesën e Shqipërisë që ta rrëzoni një rezolutë që degradon luftëtarët e Ushtrisë heroike Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Rama.



KRYETARI I ALEANCËS PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK), RAMUSH HARDINAJ, KA KËRKUAR QË KRYEMINISTRI ALBIN KURTI TË RAPORTOJË NË KUVEND PËR DIALOGUN ME SERBINË

Haradinaj kërkon që Kurti të japë sqarime për dokumentin franko-gjerman

Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Hardinaj, ka kërkuar të premten nga kryeministri Albin Kurti që të raportojë në Kuvend për dialogun Kosovë - Serbi, veçanërisht për dokumentin franko-gjerman që është duke qarkulluar si ide kohën e fundit. Ish-kryeministri Haradinaj ka thënë se në procesin e dialogut Kosovë - Serbi ka vetëm një dokument: ai amerikan-evropian

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 TETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Hardinaj, ka kërkuar të premten nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, që të raportojë në Kuvend për dialogun Kosovë - Serbi. Në deklaratimet jashtë rendit të ditës, në seancën e Kuvendit, Haradinaj ka thënë se Kurti e ka obligim një gjë të tillë. "Duhet të japë sqarime kryeministri për këtë, dhe më se miri është t'i japë në Kuvend, jo me e ndjek

gazetarët në traktor. Pra të tregojë se çka është puna e këtyre dokumenteve, një dokument franko-gjerman e një dokument i dikujt tjetër. Kryetari i qeverisë ia ka borxh Kuvendit të tregojë çfarë është kjo punë", ka thënë Haradinaj. Ish-kryeministri Haradinaj ka theksuar se ka vetëm një dokument për këtë çështje. "Sipas meje, nuk ka dokument franko-gjerman. Është ajo loja e njohur e spekulimeve që i bëjnë kuzhinat e caktuara. Ka vetëm një dokument: amerikan-evropian dhe kushdo që vjen nga

institucionet ndërkombëtare përfaqëson të njëjtin dokument", ka thënë Haradinaj. Ndërkaq kryeministri Kurti ka thënë më 12 tetor se nuk ka propozim për marrëveshje finale. "Ka diskutime, ka opsione, ka teste e sprova, por nuk mund të them se ka diçka të ngurtësuar që do ta prezantonim në formë përfundimtare", ka deklaruar Kurti në një konferencë për medie mbajtur në Prishtinë. Ambasada e Francës dhe e Gjermanisë në Prishtinë nuk kanë konfirmuar nëse ekziston një propozim i tillë, por krerët e këtyre dy shteteve, Emmanuel Macron dhe Olaf Scholz, përmes një letre të dërguar në shtator, kanë kërkuar nga Kurti dhe Vuçiqi të jenë të gatshëm për vendime të vështira në dialog. Përveç shteteve evropiane, që po tentojnë t'i shtynjë përpara palët drejt një marrëveshjeje, Shtetet e Bashkuara, po ashtu, po kërkojnë që takimet të shtohen. Në këtë kuadër, sekretari

amerikan i Shtetit, Antony Blinken, më 11 tetor ka thënë se ka biseduar me Kurtin dhe Vuçiqin për nevojën e "shtimit të procesit të dialogut drejt një marrëveshjeje ligjërisht të obligueshme me njohje reciproke në qendër të saj". Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, është takuar të enjten në Prishtinë me kryeministrin Albin Kurti, me të cilin ka diskutuar për ecurinë e dialogut. Pas takimit me të, Lajçaku ka thënë për mediet se të dyja shtetet nuk duhet ta shpërdorin mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për normalizimin e raporteve. Ai ka theksuar se në takimin me Kurtin ka biseduar edhe për "diskutimet që ne kemi nisur së fundmi" që, sipas tij, kanë vazhduar përmes ndërhyrjes së presidentit të Francës, Emmanuel Macron, kancelarit gjerman Olaf Scholz dhe bisedës telefonike që

sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka zhvilluar me liderët e Kosovës dhe Serbisë. "Ne kemi diskutuar për hapat e mëtejshme. Pika e dytë në agjendë ishte për çështjet aktuale, veçanërisht çështja e energjisë dhe e targave. Siç e dini, afati i fundit për targat e makinave është më 31 tetor dhe është shumë e rëndësishme për mua dhe për ne si BE dhe komunitet ndërkombëtar të dimë se cilat janë planet dhe të shmangim ndonjë përshkallëzim të situatës. Kjo nuk është në interesin e askujt", ka deklaruar Lajçaku. Ndërkaq nga Zyra e Kurtit njoftuan se në takim është diskutuar për përgatitjet e takimit të radhës të dialogut në Bruksel. "Në takim u bisedua për ecurinë e mëtejshme të procesit të bisedimeve në Bruksel dhe për përgatitjet për takimet e radhës në kuadër të dialogut për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe

Opozita kërkon shpjegime për vizat

PRISHTINË, 14 TETOR - Partitë opozitare në Kosovë janë shprehur të zhgënjyera me vendosjen e kushteve të reja për liberalizimin e vizave për Kosovën, duke argumentuar se vendi për një kohë të gjatë ka përmbushur kriteret për këtë proces.

Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i kanë kritikuar autoritetet në Kosovë dhe kanë kërkuar që institucionet shtetërore të ndërmarrin veprime që shteti të lëvizë drejt integritimit evropian.

Xhafer Tahiri nga LDK-ja në një konferencë për medie më 14 tetor ka thënë se është e padrejtë që shtetasit e Kosovës vazhdojnë të jenë të vetmit në rajon që nuk mund të lëvizin pa viza në zonën Shengen. "Mua më shqetëson fakti nëse Qeveria e Kosovës nuk ka pasur informacion mbi kërkesat e reja të shteteve anëtare të BE-së,

qoftë edhe kërkesa teknike, sepse kërkesa të tilla nuk bëhen aty për aty në takime. Kjo lë të kuptohet se qeveria jonë nuk ka zhvilluar mjaftueshëm dialog me vendet anëtare veç e veç, po ashtu e vërteton faktin se qeveria është pa strategji në politikë të jashtme dhe këtë e kemi thënë shumë herë", ka thënë Tahiri.

Më 13 tetor, në takimin e grupit punues për viza të Këshillit të BE-së, Radio Evropa e Lirë mësoi se zyrtarët francezë kanë propozuar që liberalizimi i vizave për Kosovën të lidhet me funksionalizimin e sistemit për siguri në Evropë, ETIAS.

Kjo ide e Francës është mbështetur edhe nga Suedia, Belgjika, Holanda dhe Spanja.

Më 2018, pas përmbushjes së kriterëve, Komisioni Evropian kishte rekomanduar liberalizimin e vizave për Kosovën.

Shefi i grupit parlamentar i

AAK-së, Besnik Tahiri, pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit, kritikoi Qeverinë dhe Kuvendin pasi, siç tha ai, këto institucione nuk kanë bërë asnjë komunikim zyrtar që të kërkojnë nga institucionet përgjegjëse në pyetjen "pse po bëhet ky diskriminim ndaj qytetarëve të Kosovës". "Dje u vendos edhe një kusht, nesër do të dalë edhe një shtet tjetër dhe do të vendosë edhe një kusht. Ky trajtim jodinjitoz i Kosovës duhet të ndalohej. Drejtimi ynë dihet, është pro-perëndimor", ka thënë ai, duke shtuar se Kuvendi dhe Qeveria duhet të dërgojnë porosinë te secili vendimmarrës në BE për orientimin pro-perëndimor të Kosovës dhe shtoi se "nëse kryeministri i Kosovës e ka ndonjë kusht, duhet t'i tregojë popullit të tij, në qoftë se jo, duhet ta trajtojë këtë çështje seriozisht".

Por, shefja e grupit parlamentar

e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se nuk ka konfirmim zyrtar për kërkesat apo kushtet e tjera teknike për çështjen e liberalizimit. "Në këtë proces, gjithashtu, nuk ka asnjë dyshim që të themi se Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet për liberalizim të vizave për qytetarët e saj dhe tashmë duhet të jemi bashkëpunues dhe të fokusohemi në ato punë, në ato angazhime të cilat na presin në Kosovë. Unë besoj se procesi, si i tillë, do ta vazhdojë rrugën e vet dhe Kosova pashmangshëm është në një udhëtim njëdrejtimësh, do të thotë integrimi i Kosovës në BE nuk ka alternativë dhe ky është qëndrimi ynë në të gjitha funksionet që i ushtrojmë, qoftë në legjislativ apo në ekzekutiv", ka thënë Kusari-Lila pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Edhe presidenca çeke e BE-së

tha pas takimit të 13 tetorit se në mënyrë që të ecet para në procesin e liberalizimit të vizave, "është e domosdoshme të qartësohen disa çështje dhe të vazhdohen diskutimet".

Takimi i radhës i grupit punues për vizat është paraparë të mbahet në nëntor.

ETIAS është sistem evropian për autorizim dhe informacione rreth udhëtimit. Ky sistem - krejtësisht elektronik - mundëson verifikimin e të dhënave të qytetarëve të vendeve të treta, që nuk kanë nevojë për vizë, për të hyrë në zonën Shengen. ETIAS është kërkuar që funksionalizohet pas shqetësimeve në rritje për terrorizmin dhe krizën me migrantë në Evropë.

Procedura ligjore për ta miratuar sistemin ETIAS ka nisur më 2016 dhe sistemi pritet të jetë plotësisht operacional brenda vitit 2023, pa ndonjë datë të saktë.



Serbisë. Kryeministri Kurti ritheksoi se Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për kornizën e përgjithshme të marrëveshjes ligjrisht të obligueshme, marrëveshje kjo e cila sjell normalizim të plotë, sepse e ka në qendër njohjen reciproke", bëhet me dije në njoftimin e qeverisë.

Më tutje theksohet se gjatë takimit u potencua Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, i pranuar dje, si dukshëm më i mirë sesa vitin e kaluar dhe si një ndër raportet më të mira në rajon. "U tha se ky raport tregon qartë përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për agjendën e BE-së

dhe dëshmon arritjet e shënuara në shumë fusha, që kanë kaluar një hap më lart në shkallët e progresit. U bisedua për çështjet aktuale, si dhe për domosdoshmërinë e zbatimit të marrëveshjes për energjinë, që përfundimisht shpie në pagesën e energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës", ka njoftuar

Qeveria e Kosovës. I dërguari i bllokut evropian për dialogun tha se në javën e ardhshme do ta vizitojë Beogradin, me të njëjtin qëllim dhe agjendë.

Vizita e Lajçakut në Kosovë më 13 tetor erdhi në kohën kur mediet kanë raportuar se Franca dhe Gjermania ua kanë paraqitur

Kurtit dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, një propozim për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Kosova dhe Serbia që nga viti 2011 zhvillojnë dialog me ndërmjetësimin e BE-së. Këto dy shtete, megjithatë, kanë qëndrime të kundërta sa i përket përfundimit të dialogut.

Latifi dhe Aliu nënshkruajnë memorandum për rregullimin e shtretërve të lumenjve

RAHOVEC, 14 TETOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi dhe ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, kanë nënshkruar një aneks memorandum mirëkuptimi për vazhdimin e bashkëfinancimit të projektit: "Rregullimi i shtretërve të lumenjve në fshatrat Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe". Me anë të kësaj marrëveshjeje MMPHI për këtë vit do të

sigurojë mjete në vlerë prej 60 000.00 eurosh për realizimin e këtij projekti. "Po ashtu, diskutuam për nevojën e bashkëpunimit në projekte të tjera në interes të qytetarëve të komunës së Rahovecit, e që ndërlidhen me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Falënderoj ministrin Aliu për këtë marrëveshje dhe investimet e ministrisë në komunën e Rahovecit", ka theksuar Latifi.



Vrasja e Agonis Tetajt, Shaban Gogaj dënohet me 7 vjet e 6 muaj burgim

PEJË, 14 TETOR - Gjykata Themelore në Pejë e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me 7 vjet e 6 muaj burgim të akuzuarit

Shaban Gogaj për vrasjen e Agonis Tetajt në shtator të vitit 2018 në Deçan. Aktgjykimi ndaj të akuzuarit

Gogaj është shpallur të premtën nga kryetarja e trupit gjykues, Violeta Husaj-Rugova, raporton "Betimi për drejtësi".

Totaj pret në takim informativ vullnetarët amerikanë të Korpusit të Paqes



PRIZREN, 14 TETOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të premtën në një takim informativ vullnetarët amerikanë të Korpusit të Paqes (Peace Corps), me të cilët ka diskutuar për mundësinë e angazhimit të tyre në avancimin e komunës si qeverisje lokale. Kryetari Totaj fillimisht i ka njoftuar për funksionimin e komunës dhe me jetën në Prizren, që zhvillohet në paqe me të gjitha elementet që

e bëjnë qytet unik dhe shumëdimensional. Një nga vullnetarët do të qëndrojnë në Prizren, ndërsa për fushën e angazhimit do të vendoset në ditët në vijim. Korpusi i Paqes zyrtarisht u themelua më 1 mars 1961 nga presidenti John F. Kennedy me qëllim të promovimit të paqes dhe miqësisë në botë, duke ofruar vullnetarë amerikanë për të kontribuar në zhvillimin social, ekonomik dhe njerëzor në vendet

nikoqire ku ata shërbejnë. Që nga viti 1961 mbi 200 000 amerikanë kanë shërbyer në Korpusin e Paqes në 140 vende të ndryshme. Kosova u bë vendi i 140 në qershor të vitit 2014. Deri më tani kanë ardhur 6 grupe të këtyre vullnetarëve, ndërsa më 12 shtator të këtij viti ka arritur grupi i 7-të prej rreth 20 personave të cilët do të angazhohen në shkollë, komuna dhe organizata të shoqërisë civile në mbarë Kosovën.

Gjilani shpërndan 140 tonë farë gruri për 734 fermerë

GJILAN, 14 TETOR - Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Gjilan ka shpërndarë mbi 140 tonë farë gruri. Përfitues kanë qenë 734 fermerë. Kryetari i komunës, Alban Hyseni, ka paralajmëruar se

buxheti për bujqësinë në vitin e ardhshëm është 100 për qind më i madh krahasuar me këtë vit. "Vëmendjen po e kthejmë edhe kah bujqësia", ka thënë kryetari Hyseni.



Vetëm katër raste të reja me Covid në 24 orët e fundit

PRISHTINË, 14 TETOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e

fundit, pas 77 testeve, janë konfirmuar 4 raste të reja me Covid-19.

Sipas këtij raporti të MSh-së, 2 persona janë shëruar. Raste aktive janë 23.

Ndërkaq në 24 orët e fundit vaksinën e kanë marrë 10 persona



Mësimi dual po pilotohet suksesshëm në Kosovë

PRISHTINË, 14 TETOR - Të premtën janë nënshkruar marrëveshjet në mes të Qendrës së Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" dhe përfaqësuesve të bizneseve si dhe kontratat me 25 nxënës të profilit të Floktarisë për kryerjen e praktikës profesionale në ndërmarrje. Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka bërë me dije se këta nxënës shumicën e kohës do ta kalojnë në sallone të floktarisë duke u aftësuar nga

floktarë profesionalë. "Jam e bindur se pas përfundimit të shkollimit shumë lehtë do ta gjejnë veten në tregun e punës. Përvojat e dëshmuara në vendet si Gjermania, Austria dhe Zvicra për herë të parë po implementohen edhe në Kosovë", ka thënë ministrja Nagavci.

Ajo ka theksuar se, bazuar në bashkëpunimet e deritanishme me bizneset, pilotimi i arsimit dual po realizohet suksesshëm dhe po

ofrohen mundësi të zgjerimit edhe në profile të tjera. "Falënderoj shumë bizneset të cilat kanë shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar me shkollat dhe kanë hapur dyert për nxënësit. Fokusi ynë është ta fuqizojmë arsimin dhe aftësimin profesional me qëllim që t'i përafrojmë profilet të cilat ofrohen nga shkollat profesionale me nevojat e bizneseve", ka thënë Nagavci.



Mbahet konferenca "Gratë në politikën e jashtme"

SHKUP, 14 TETOR - Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, me ftesë të zëvendësministres të Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Fatmire Isaku, ka marrë pjesë në konferencën "Gratë në politikën e jashtme" që po mbahet në Shkup, në të cilën po diskutohet për domosdoshmërinë e përfshirjes së grave në pozitat vendimmarrëse, rolin e tyre në politikëbërje dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare si dhe çështje të tjera me rëndësi.

Në fjalën e saj para të pranishmëve, zëvendësministrja Gashi e ka vlerësuar tejet të rëndësishme këtë konferencë në të cilën po shkëmbehen përvoja dhe pikëpamje në lidhje me arritjet e përfaqësimit gjinor.

Zëvendësministrja Gashi ka theksuar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për avancimin e rolit

të gruas në shoqëri, përkatësisht përfaqësimin e saj në pozita vendimmarrëse, gjë e cila ka reflektuar edhe në përbërjen e kabinetit qeveritar, ku gjashtë nga pesëmbëdhjetë ministri udhëhiqen nga gratë, përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. "Gratë në pozitat vendimmarrëse në Kosovë kanë dëshmuar se suksesi është i mundur pavarësisht gjinisë", ka pohuar ajo, duke shtuar se nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, deri te korpusi i grave diplomate të suksesshme, Republika e Kosovës është identifikuar me shumë gra dhe vajza të reja të cilat përfaqësojnë fusha të ndryshme nga sporti, muzika, filmi e të cilat me suksesin e tyre kanë sjellë jo vetëm Kosovën, por të gjithë Ballkanin në hartën e botës.

Në mbyllje të fjalimit të saj zëvendësministrja Gashi shtoi se



nga pozita të cilën ajo e ushtron, përparësi do t'i japë krijimit të

hapësirave nëpërmjet diplomacisë qytetare në mënyrë që më shumë

vajza dhe gra të jenë aktive në programe.

Konfirmohet aktakuza për korrupsion ndaj Dhurata Hoxhës



PRISHTINË, 14 TETOR - Gjykata e Apelit e ka konfirmuar aktakuzën ndaj ish-ministres së Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha dhe tre të akuzuarve të tjerë, Ekrem Tahiri, Fitim Mustafa dhe Gëzim Dushi. Mustafa dhe Dushi janë akuzuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, ndërsa Tahiri akuzohet për ndihmë gjatë kryerjes së veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare,

raporton "Betimi për drejtësi". Apeli i ka refuzuar të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve Fitim Mustafa, avokat Arbër Jashari, Dhurata Hoxha, avokat Florent Latifaj, Gëzim Dushi, avokate Kosovare Kelmendi dhe Ekrem Tahiri, avokat Driton Muharremi, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me kundërshtimet dhe kërkesat për

hedhje të aktakuzës. Me vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit Special, të 27 korrikut 2022, janë refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të ushtruara nga mbrojtësit e lartcekur. Më 1 qershor Hoxha dhe tre të akuzuarit e tjerë janë deklaruar të pafajshëm në seancën fillestare në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Kosova miraton Deklaratën kundër ndalimit arbitrar

PRISHTINË, 14 TETOR - Republika e Kosovës ka përmbushur edhe një zotim të Samitit për Demokraci, duke miratuar Deklaratën kundër ndalimit arbitrar. Me miratimin e kësaj deklarate Kosova rreshtohet krahas shteteve të përkushtuara për të drejtat e njeriut, sundimit të rendit dhe ligjit, si dhe pavarësisë së gjyqësorit. Me këtë deklaratë, Kosova,

sikurse edhe shtetet e tjera, ka riafirmuar shqetësimin për përdorimin e ndalimit arbitrar nga shtetet për të ushtruar ndikim mbi qeveritë e huaja, veprim ky në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Miratimi i kësaj deklarate është hap i rëndësishëm i përmbushjes së zotimeve të bëra nga presidentja Vjosa Osmani në emër të

institucioneve të Republikës së Kosovës, në Samitin për Demokraci, iniciativë e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden.

Deklarata është iniciativë e Kanadasë, e cila synon t'i mbrojë edhe më tutje të drejtat e qytetarëve, të cilët jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë jashtë shteteve të tyre amë.



Kushtëzim i vizave nga Franca dhunon Liberte, Egalite dhe Fraternite!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Sistemi ETIAS dhe Dardha e Ahmetit? Më 13 tetor 2022 nuk Bruksel u mbajt takimi në të cilin diskutohej për liberalizimin e vizave për Kosovën e që pritet ishin të mëdha, madje ishin komunitetet pakicë ato që ishin hezituese për një vendim pozitiv. Unë isha pjesë e këtij komuniteti, jo se Kosova nuk i ka plotësuar kushtet, por se jam shumë i sigurt se kjo vendimmarrje është e kushtëzuar me përparimin në bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë. Ndërkombëtarët, përmes një mashtruesi si puna e Lajçakut, liberalizimin e vizave po e keqpërdorin për shantazhim që Kosova të lëshojë pe në këto bisedime. Deri tash e kanë përdorur si shkop me mundësi të shndërrohet në karotë, nëse bëhemi të dëgjueshëm. Kjo nuk vlen për Serbinë shkaku se i janë toleruar të gjitha të bëmat kundër rendit dhe sigurisë rajonale dhe globale, që nga krimet e fundit në hapësirat e ish-Jugosllavisë, shitja e armëve grupeve dhe vendeve terroriste sikur edhe përkrahja e pazezervë e Rusisë dhe Putinin në pushtimin e Ukrainës. Deri më tani Serbia nuk ka pranuar t'i vendosë sanksione Rusisë, ndërsa ka dalë kundër aneksimit të territorit të okupuar të Ukrainës për faktin e vetëm që Kosovën ende e konsideron pjesë të saj. Kosova që nga viti 2018 i ka plotësuar kushtet për liberalizim të vizave, ndërsa disa vende hezituese si Holanda, Franca, Gjermania, Spanja, Belgjika kanë parashtruar kërkesa shtesë për ta maskuar qëllimin e vërtetë dhe të vetëm: marrëveshjen përfundimtare me Serbinë, me gjasë në dëm të Kosovës. Publikisht nuk mund ta thonë se liberalizimi i vizave kushtëzohet me rezultatin e dialogut me Serbinë sepse janë procese të ndara, mirëpo vetë fakti se gjithmonë e gjejmë një arsye për të fituar në kohë e

qartëson dyfytërsinë dhe qasjen shantazhuese të disa vendeve përmes instrumenteve të padinjitetshme si puna e Lajçakut dhe Borrellit. Ndonëse data 13, sipas paragjyqimeve, është datë ters, pritet ishin të mëdha dhe, jo që nuk diskutohej nëse do të liberalizohen vizat, por se bëheshin plane se në cilin muaj qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza. Qeveria aktuale, përmes disa ministrave krejtësisht të painformuar dhe të paditur, deklaroi, me mburrje dhe pa fije turpi, se “qeveria ka punuar shumë në dy vitet e fundit, prandaj edhe do të liberalizohen vizat”, duke i fajësuar “shkatërruesit e shtetit” se pamundësuan këtë liberalizim. Tash janë futur në birën e miut 300 goshë (autor Fadil Hoxha) dhe nuk u dëgjohej zëri. Në vend të tyre po flasin disa gazetarë të oborrit dhe disa analistë, palaço gjithashtu të oborrit. Qëllimi është të relativizohet ky kushtëzim i Francës, i përkrahur nga katër shtetet e tjera, ndërsa “radikalët” kërkojnë që t'i shpallet luftë Francës! Teneqe mbi teneqe. Parimi i llamarinës, nxehemi shpejt dhe ftohemi edhe më shpejt!

Po të ishte Zafiri, Franca nuk do të dilte me këtë kushtëzim: Se procesi është i kushtëzuar me bisedime, qartazi vërtetohet me faktin se mashtruesi dhe gënjeshtari Lajçak, në ditën kur bisedohej në Bruksel për liberalizim të vizave për Kosovën, heshtazi erdhi në Kosovë dhe u takua me kryeministrin e Kosovës për të biseduar, gjoja, për energjinë dhe tabelat dhe, ashtu rrugës, e caktoi një takim midis Kurtit dhe Vuçiqit. Sa i përket energjisë, Kurtit iu bë me dije se nuk duhet (nuk guxon) t'i ndërpritet kontrata dhe t'i merret leja e punës kompanisë së Serbisë “Elektrosever”, ndonëse i ka

tejkalluar të gjitha afatet e parapara. Natyrisht se do të vazhdohet edhe me pagesën e rrymës për serbët e veriut të Kosovës, sigurisht për shkaqe humane, se nuk duhet të lejohet që të mërdhijnë në kohë të dimrit sikur që nuk u lejua që të dehidroheshin gjatë verës për shkak të temperaturave të larta. Ne shqiptarët dhe të tjerët jemi mësuar të jetojmë në këto kushte sepse e kurdisim refleksin që të përshtatemi edhe me reduktime 6 orë me rrymë e 6 pa rrymë. Sipas nevojës, e rrisim këtë përqindje. Por, pasi po durojmë, pak po na bëjnë! Ndërsa sa i përket targave të veturave, nuk qëndrojmë keq, kemi lëvizur nga pika zero, për 10 000 vetura janë ndërruar 12 tabela. Kërkohen afate e afate të reja për një problem shumë teknik. Merreni me mend, serbët janë liruar nga të gjitha pagesat dhe dënimet me kusht që t'i ndërrojnë tabelat kurse ne, po u vonuam 24 orë, na fusin gjobë. Çfarë diskriminimi po iu bëhet popullit tokësor (shqiptarëve dhe joserbëve) dhe çfarë favore po i bëhen popullit qiellor (serbëve)! Një gjë është e qartë, “Elektrosever”-it nuk do t'i hiqet leja e punës, serbëve do t'u paguhet rryma sikur që afati për tabela do të zgjatet jashtë dëshirës së palës kosovare.

Ndërkombëtarët po insistojnë për Zajebnicën në formë që përmbajtjesisht e shkatërron subjektivitetin shtetëror të Kosovës dhe e dhunon integritetin territorial ndonëse e mohojnë këtë. Edhe në Konferencën e Dejtonit ishte një qëndrim i prerë se nuk do të lejoheshin ndarja e Bosnjës. Praktika na tregon sa u respektua premtimi, kurrë Bosnja nuk ka qenë më e ndarë. Qeveria e Kosovës deri më tani nuk e ka asnjë draft në tavolinë për Zajebnicën, kurse një shtet evropian që do ta marrë flamurin e kësaj çështjeje e ka një propozim për Zajebnicën që e dallon statusin e Zajebnicës nga Republika Serbe në Bosnjë vetëm se nuk ka ushtri të rregullt. Gjitha të tjerat do t'i ketë Zajebnica sipas këtij drafti: policinë, infrastrukturën administrative dhe të tjera, kurse njësitë paramilitare i ka aktive edhe sot, që nga viti 1999. Francezët, si kushtëzim (teknik), unë e them politik, e vendosën një sistem të automatizuar të IT i krijuar për të identifikuar çdo risk që lidhet me një vizitor të përjashtuar nga viza që udhëton në zonën Shengen të emërtuar si ETIAS. Duket se ishte edhe një kërkesë

për harmonizim të vizave me shtetet e BE-së, ndër të tjera. Është një dukuri që gjatë udhëtimit, edhe nëse keni vizë të rregullt dhe e keni kaluar kontrollin hyrës sipas procedurave, ju veçojnë edhe për një kontroll tjetër, double check. Më ka ndodhur edhe mua gjatë një udhëtimi kur më kanë futur për një kontroll shtesë. Në atë dhomë isha unë, një vajzë nga Gostivari, pakistanezë, arabë, sirianë etj. Përzgjedhja ishte bërë sipas emrit, besimit fetar dhe vendit të origjinës. Kontrollimi ishte poshtërues. Prandaj, më ha mendja që propozimi francez ka të bëjë pikërisht mbi këto baza ndonëse nuk ishte plotësuar ky kusht as nga shtetet që kanë përfutur nga liberalizimi i vizave. Po na fusin në radhët e shteteve islamike dhe në emër të luftimit të islamit radikal po na penalizojnë ndonëse nuk kemi lënë hoxhë në Kosovë pa e kapur për ko..., në emër të luftës dhe aleancës globale kundër ekstremizmit islam.

Vetëm pas propozimit bllokues të Francës po e ndiejmë mungesën e Zafir Berishës që ishte Njëshi në Kosovë për parandalimin e sulmeve kibernetike sepse kishte një program shumë të sofistikuar e të mbështetur në arritjet më të përparura të teknologjisë informative. Dëshëm apo nuk deshëm, na pëlqeu apo nuk na pëlqeu, duhet ta pranojmë se gjatë mandatit të Zafës sulmet kibernetike nuk ishin të pranishme në Kosovë sikur që IT funksiononte perfekt. Dëmi i vetëm që bëhej në këtë lëmë ishte ndërprerja e internetit nga Ipko, Kujtesa dhe operatorët e tjerë, qoftë për shkak të mospagesës apo problemeve teknike. E kjo nuk ishte përgjegjësi e Zafës. Po te shqiptarët është thuaja rregull që vlerësimin për një personalitet e kemi të drejtë vetëm kur e humbim apo kur mbesim pa të!

Po pse Franca, si vend i motos kombëtare Liberte (Liri), Egalite (Barazi) dhe Fraternite (Vëllazërim), doli me një kërkesë bllokuese për liberalizim të vizave?! Një mik imi e që është njohës i mirë i rrethanave kombëtare dhe ndërkombëtare mendon se refuzimi i Francës ndërlidhet me fjalimin e Edi Ramës në Parlamentin Evropian në Strasburg, kryeqyteti i të drejtave të njeriut i mbarë botës e që është në Francë. Mund të jetë një ndër shkaqet, mirëpo mendoj se arsyeja kryesore e që është edhe hakmarrje personale e presidentit Makron është se deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk e votuan Ligjin

për LGBTI. Vetëm ky kusht ka mbetur i paplotësuar në aspektin e të drejtave të njeriut e francezët këtë nuk e falin.

Sidomos Emanuel Makron, president i Francës, shtet që moton Liberte, Egalite dhe Fraternite e ka të skalitur në të gjitha institucionet si dhe në monedhat metalike të Francës dhe të njëjtën moto, njëri ndër udhëheqësit e Revolucionit Francez, Maksimilain Robespier e jo Allegri, pati kërkuar që të vendoset në flamurin francez. Me këtë qëndrim kushtëzues të Francës për liberalizim të vizave, presidenti Makron dhe Franca kanë dhunuar brutalisht moton Liberte, Egalite dhe Fraternite që përbën bazë dhe shtytje për të drejtat e njeriut e që Franca konsiderohej se ishte vendlindja e tyre!

Është e sigurt se pa na i fut dy këmbë në një opingë nuk do të ketë liberalizim të vizave. Modeli i dy gjermanive, liberalizimi i vizave me Bangladeshin, modeli i Alto Adixhes apo Tirolit të Jugut, modeli Republika Srpska, modeli i Belgjikës, i Kuebekut në Kanada përmes Zajebnicës, a është kjo perspektive e Kosovës dhe mundësia të kemi liberalizim të vizave?! Nëse po, atëherë t'i pshursha këto viza me këto kushte!

Rruga e Golgotës e Policisë së Kosovës: Policët e Kosovës asnjëherë nuk janë trajtuar në përputhje me punën që e kanë bërë. Janë sulmuar dhe rrahur nga paramilitarët politikë shqiptarë, janë veshur si mos e më keq, ushqimi ka qenë i pamjaftueshëm si në aspektin e cilësisë ashtu edhe të sasisë, jo rrallë edhe me afat të skaduar; në vend të parimit të profesionalizmit është kërkuar multietniciteti; këmishët dhe uniformën e ngjyrosin me shpenzime të veta shkaku se e humbin ngjyrën edhe për shkaqe të vjetërsisë, edhe nga mungesa e cilësisë, këpucët i kanë si t'ua kishte bërë Migjeni te Luli i Vogël, në veri të Kosovës janë vlarë, rrahur dhe fyer nga paramilitarët serbë dhe civilët, gjithashtu paramilitarë, thjesht, aspak të vlerësuar sikur të ishin personazhe të Dostojevskit në romanin “Të poshtëruar dhe të fyer” apo “Të Mjerët” e Viktor Hygosë.

Së fundi u është shtuar edhe një angazhim shtesë dhe përgjegjësi e rëndësishme; 24 orë duhet të kujdesen për qetësinë, sigurinë, rehatinë dhe komoditetin e një peci! Haj medet, haj!

Bislimi: Të ndalohet dezinformata se qeveria po i mban paratë dhe nuk po i shpenzon

PRISHTINË, 14 TETOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, i ka quajtur dezinformata deklarimet se qeveria po i mban paratë në thesar e nuk po i shpenzon ato. Ai ka thënë se këtë vit kanë 0.7 për qind më pak mjete në thesar krahasuar me vitin 2021, ndërkohë që, sipas tij, janë rritur të hyrat buxhetore për 12.1-përqindësh.

Megjithatë, sipas Bislimit, filozofia e qeverisjes nuk duhet të jetë që të shpenzojë çdo mjet që ka, por të jetë e aftë për ndërtimin e një strategjie afatgjatë. "Në ditën e sotme të vitit të kaluar në thesarin e Republikës së Kosovës kemi pasur mjete 702 milionë euro. Sot në Thesar kemi 697 milionë euro. Pra, kemi mjete më pak se vitin e kaluar. Kemi 0.7 për qind

më pak mjete në Thesar sesa që kemi pasur në vitin 2021, ndërkohë që të hyrat buxhetore janë rritur për 12.1 për qind. Është mirë që të ndalohen dezinformatat. Në fakt, filozofia e qeverisjes nuk duhet të jetë se kudo që ka një lekë ta shpenzojë, por është aftësia për të ndërtuar një strategji pak më afatgjatë", ka thënë Bislimi.



Qeveria shkurton ditët e pushimit nga përvoja e punës për zyrtarët publikë



Neni 10 Pushimi vjetor

1. Zyrtari publik për çdo vit kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor me pagesë në një kohëzgjatje prej njëzet (20) ditë pune, pavarësisht: a punon me orar të plotë apo të shkurtuar.
2. Zyrtari publik i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat përkundër aplikimit të masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor në kohëzgjatje së paku prej tridhjetë (30) ditësh pune, për vitin kalendarik.
3. Zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një (1) ditë pune.
4. Nënata apo prindit kujdestar/vetushqyes i fëmijës deri në tre (3) vjeç.

Article 10 Annual leave

1. The public official shall be entitled to a paid annual leave for each calendar year for a duration of twenty (20) working days, regardless of whether he/she works full-time or part-time.
2. The public official performing tasks and duties which despite the application of protective measures contain their harmful effect is entitled to an annual leave of at least thirty (30) working days for a calendar year.
3. The extension of annual leave shall be defined based on work experience, whereby one (1) day shall be added for every five (5) years of service.
4. Mothers or guardians/single parent of a child up to three (3) years old, as well as a

Član 10 Godišnji odmor

1. Javni službenik za svaku kalendarisku godinu ima pravo na plaćeni godišnji odmor u trajanju od dvadeset (20) radnih dana, bez obzira da li radi sa punim ili skraćanim radnim vremenom.
2. Javni službenik koji radi na poslovima i radnim poslovima za koje se, i pored primene zaštitnih mera, ne može se zaštititi od štetnih uticaja, ima pravo na godišnji odmor u trajanju od najmanje trideset (30) radnih dana, za kalendarisku godinu.
3. Produženje godišnjeg odmora utvrđuje se u zavisnosti od radnog staža, pri čemu se na svakih pet (5) godina radnog staža dodaje jedan (1) radni dan.
4. Dva (2) dodatnih radnih dana na plaćenom godišnjem odmoru ostvaruju majke

Activate Windows

PRISHTINË, 14 TETOR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar rregullore të re për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publikë. Këtë rregullore të re e ka siguruar gazeta "Epoka e re".

Në Rregulloren (QRK) nr. 07/2022 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve Publikë, e cila është aprovuar në mbledhjen e 99 të Qeverisë së

Republikës së Kosovës, në bazë të vendimit nr. 08/09, datë 30.09.2022, parashihet shkurtim i ditëve të pushimit nga përvoja e punës për zyrtarët publikë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje është shfuqizuar Rregullorja (QRK) nr. 12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publikë. Në rregulloren e mëparshme, të vitit 2020, zyrtarët publikë për

përvojën e punës merrnin edhe një ditë pushim shtesë çdo dy vjet. Tash, me rregulloren e re për zyrtarët publikë, ata do të marrin një ditë pushim shtesë çdo pesë vjet për përvojën e punës. Do të thotë, me rregulloren e vjetër, nëse një i punësuar ka pasur përvojë pune 20 vjet, i kanë takuar, përpos pushimit vjetor, edhe dhjetë ditë të tjera pushim për

përvojën e punës. Me rregulloren e re zyrtarëve publikë që kanë përvojë pune 20-vjeçare do t'u takojnë vetëm katër ditë pushim shtesë. Ndryshime të tjera në rregulloren e re nga ajo paraprake vërehen edhe te neni 15, te përshkrimi "Mungesa në punë me pagesë": "Zyrtari publik ka të drejtë të mungojë nga puna me kompensim të

pagës për rastet si në vijim: 1.1. pesë (5) ditë në rast të martesës së tij; 1.2. pesë (5) ditë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes; 1.3. tri (3) ditë për lindje të fëmijës; 1.4. dy (2) ditë pune për çdo rast të dhënies vullnetare të gjakut, duke përfshirë ditën e dhurimit". Po ashtu, ndryshime në rregulloren e re nga ajo paraprake vërehen edhe në nenet e tjerë.

Guvernatori Mehmeti vazhdon takimet me përfaqësues të FMN-së dhe të BB-së

PRISHTINË, 14 TETOR - Gjatë qëndrimit në takimet vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, po vazhdon takimet me përfaqësues të këtyre dy institucioneve.

Guvernatori Mehmeti ka zhvilluar takime me udhëheqësin e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar

për Kosovën, Di Bella, si dhe me drejtorin e Konstituencës sonë në Fond, Palotai.

Gjatë kësaj periudhe guvernatori Mehmeti u takua edhe me drejtorin e Departamentit Evropian të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Alfred Kammer, të cilin e njoftoi për zhvillimet e fundit në sistemin financiar të Kosovës, i cili po vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në mbështetje të

zhvillimit ekonomik të vendit. Në takimim me zëvendëspresidenten e Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore, Anna Bjerde, përveç diskutimit lidhur me zhvillimet në sistemin financiar në vend, u diskutua edhe për mbështetjen e mëtutjeshme të BQK-së përmes projekteve të ndryshme me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit financiar në Kosovë.



Jeta dhe fati: Një roman sovjetik, 'shumë i rrezikshëm për t'u lexuar'



Nga: Nicholas BARRETT / BBC

Muajt e fundit, protestuesit në Rusi janë arrestuar për mbajtje të pankartave pa fjalë, për dhënien e kopjeve të veprës "1984" dhe për përshkrimin si "luftë" të një konflikti që tashmë ka vrarë dhjetëra mijëra ushtarë rusë. Liria e shprehjes ka pasur histori elastike në Rusi. Liritë kanë ardhur dhe kanë shkuar, ndërsa agimet e rreme ngacmojnë horizontin. Një rast erdhi në vitin 1956, kur Nikita Hrushovi, si udhëheqës i BRSS-së, për herë të parë kryesonte Kongresin e Partisë. Teksa konferenca përfundoi, një thashetheme nisi të qarkullojë nëpër sallën e kongresit. Do të mbahet një "seancë e mbyllur" më vonë, po atë mbrëmje. Askush nga shtypi apo jashtë Bashkimit Sovjetik nuk lejohet të merrte pjesë. Kur Hrushovi u kthye në skenë, pak pas mesnate, bëri diçka që askush në Rusi nuk mund ta imagjinonte të dëshmonte në tri dekadat e mëparshme. E denoncoi Stalinin.

Paraardhësi i tij, deklaroi Hrushovi, kishte ndërtuar një kult pothuajse të pathyeshëm të personalitetit, të cilin e përdori për t'i shkatërruar rivalët e vet dhe për t'i dërguar në vdekje legjionet e komunistëve të pafajshëm. Në të njëjtën kohë, në kulmin e terrorit, Hrushovi ka nënshkruar dhjetëra mijëra ekzekutime; po të refuzonte, mund të cilësohej si armik i popullit dhe do të hidhej në grumbujt e të vrarëve. Megjithatë, fjalimi i tij përvëlues zgjati për katër orë – me pauza dhe me ndërprerje të shumta, teksa rojet nga audienca i largonin problematikët e indinjuar. Në atë moment, Stalin ishte ende hyjni laike, personifikimi i pavdekshëm i Rusisë dhe i revolucionit. Të vësh në pikëpyetje mençurinë e tij, privatisht e lere më publikisht, ishte si t'ia merrje vetes jetën.

Për Hrushovin, ndoshta qëllimi i menjëhershëm ishte t'i dobësojë rivalët stalinistë në Byronë Politike, por në planin afatgjatë gjithashtu përpiquej të shpërbante prej totalitarizmit. Teksa teksti i fjalimit u

mbajt sekret shtetëror, pasojat e tij u bënë shumë shpejt të dukshme. Statujat e diktatorit të ndjerë u rrëzuan, të burgosurit politikë u liruan, Stalingradi u bë Volgograd dhe Stalino ishte përsëri Donjec.

Kur kuptoi çfarë po ndodhte, shkrimtari Vasili Grosman mbase e ka ndier një shans. Lindi në një familje hebraike në Berdiciiv, qytet i vogël në perëndim të Kievit. Babai i tij ishte menshevik, një fraksion i komunistëve të moderuar që kishin marrë pjesë në revolucion, përpara se të çrrënjosehin nën Stalinin. Si i rritur, derisa punonte në një minierë qymyri në Donbas, Grosmani shkroi tregime të shkurtra të cilat do të tërhiqnin vëmendjen e Maksim Gorkit.

Në qershor 1941, Gjermania nisi pushtimin shkatërrues të Bashkimit Sovjetik, në një shkallë aq të madhe sa që është pothuajse pamundur të kuptohet. Grosmani u dërgua në vijën e frontit, si korrespondent lufte për "Krasnaya Zvezda" (Ylli i Kuq), gazetë kjo e ushtrisë e njohur mes ushtarëve dhe civilëve. U përfol se, përpara botimit, Stalini e lexonte vetë secilën faqe. Pesë muajt e parë të luftës, për mbrojtësit ishin fatkeqësi pas fatkeqësie, ndërsa Gjermania përparoi thellë në Rusi duke kapur qindra mijëra trupa sovjetike. Në BRSS, krimi i "disfatës" shpesh dënohej me vdekje. Grosmani pa dyshim pa më shumë seç mund të shkruante.

Sidoqoftë, u bë një nga gazetaret më të respektuar në BRSS. Në një kohë të represionit dhe paranojës, Grosmani e fitoi besimin e të intervistuarve, duke biseduar me ta pa bllok shënimesh. Më vonë shpjegoi se mbështetej të "bisedimet me një ushtar të tërhequr në një pushim të shkurtër. Ushitari të tregon gjithçka që ka në mendje. Askush nuk ka nevojë të bëjë pyetje". Nuk i inkurajoi të intervistuarit t'i përsërisnin aktet e ekzagjeruara të heroizmit ose t'i përsërisnin klishe të komuniste për hir të propagandës, dhe këtë as vetë ai nuk e bëri. "Ishte i jashtëzakonshëm, një intelektual hebre që respektohej nga ushtarët", thotë Sir Anthony Beevor, të cilin e

tërhoqi shumë gazetaria e Grosmanit, librat e tij rreth betejave për Stalingradin dhe Berlinin. "Sapo i lexonin artikujt e tij, panë se ishte i vetmi që shkruante të vërtetën. Grosmani i vizitonte në hendekë dhe mësonte përmendësh gjithçka që thoshin".

Por, ishte ende i kufizuar. Këtë sot mund ta shohim në romanin e tij të parë të madh, "Stalingradi", i cili u botua në vitin 1952 dhe u redaktua në mënyrë kirurgjike deri në detaje – përkritazi me mizoritë dhe të metat e Ushtrisë së Kuqe. Pas luftës u shpërblye duke u bërë seri.

Për vazhdimin e "Stalingradit", kufizimet do të hiqen. Gjatë kohës në vijën e frontit, Grosmani tha se mund ta lexonte vetëm një libër, "Lufta dhe paqja". Kur mbaronte, e niste përsëri. Është e qartë, nga madhësia dhe titulli i "Jetës dhe fatit", se Grosmani donte t'i nderonte vuajtjet që e kishin rrethuar në klasikun e vet të denjë për një Tolstoi. Dallimi ishte se Tolstoi nuk e kishte jetuar pushtimin e Napoleonit dhe romani i tij fokusohej në elitat në Shën Petersburg dhe në Moskë. Është kryesisht një fabul për princa, princesha, kontë, kontesha, diplomatë dhe generalë. "Jeta dhe fati" është histori e nënave, baballarëve, vajzave dhe djemve. Hitleri, Eichmanni dhe Stalini janë gjithashtu atje, por në pjesën më të madhe formojnë një sfond ogurzi, gjithmonë të pranishëm, por kryesisht të largët dhe gjithmonë të shkëputur nga pasojat e urdhrave të tyre.

Mes lexuesit dhe tiranëve të përvijuar gjejmë portretet e atyre që janë zënë në mes të zjarrit. Kapitujt e shkurtër tërheqës lëvizin mes tavolinave familjare të ngrënies, kampeve të të burgosurve të luftës dhe stofujve ku Grosmani, episod pas episodi, bashkon banalitetet dhe absurditetet e frontit lindor. "Një ushtar këndonte; tjetri me sytë e tij gjysmë të mbyllur, ishte përplot me parandjenja të tmerrshme; një i tretë mendonte për shtëpinë; i katërti po përtypte bukë dhe sallam dhe mendonte për sallamin; i pesti, me gojë hapur përpiquej të identifikonte një zog në

një pemë".

Rezultati është një peizazh brygelian që nxjerr në pah fshirjen e madhe të historisë, së bashku me detajet e grimcuara përbrenda. Te "Jeta dhe fati" shohim jo vetëm fshesën, por gjithë pluhurin njerëzor që është larguar së bashku me të. Ndoshta Grosmani synonte diçka si "Lufta dhe paqja", por, për shkak të kohës së tij në vijën e frontit, u përplas në gjysmë të rrugës mes epikës së Tolstois që përcaktonte një epokë, dhe tregimeve të shkurtra mikrokozmike e të përjetshme të Çehovit. Një episod i tillë e ndjek një grua të re të pamartuar të quajtur Sofja, teksa ndeshet me një djalë të vogël të pashoqëruar të quajtur David, në një kamion të ngushtë bagëtitsh në rrugën për në Aushvic. Më 1941, nëna hebraike e Grosmanit u vra nga nazistët në një ekzekutim masiv në Ukrainë, dhe raportimi i tij nga kampa i çliruar i vdekjes në Treblinkë u citua si dëshmi në Nuremberg. "Jeta dhe fati" është roman për gjenocidin, po aq sa për luftën.

Kur mbërrijnë, Davidi dënohet me vdekje. Sofja ishte mjeke dhe nazistët ishin të gatshëm ta kursejnë. Ajo refuzon. Në vend të kësaj, Sofja shkon drejt vdekjes, në mënyrë që të mund të mbajë Davidin në dhomën e gazit, duke ia lejuar vetes të ndihet si biri i saj dhe duke ia lejuar vetes të ndihet si nënë. Romani është i mbushur me "akte të përditshme të mirësisë së zakonshme, që nuk janë të motivuara nga morali, por janë të motivuara nga momenti", thotë Linda Grant, romanciere që u kaptua nga "Jeta dhe fati", pasi pa emrin e Grosmanit në fusnotat e Beevorit. Ideologjia është helmi që i kthen njerëzit kundër njëri-tjetrit në pothuajse çdo pjesë të historisë. Ushtarët, revolucionarët dhe civilët njësoj denoncohen nga stalinistët e drejtë. Për të mbetur gjallë, edhe ata i tradhetojnë të pafajshmit. Grosmani e dinte këtë, sepse kjo i kishte ndodhur edhe atij. Ishte komprometuar dhe kishte kompromentuar të tjerët, jo për të pasur sukses, por thjesht për të mbijetuar. "Mësimi është se ju nuk

duhet të besoni në ideologjinë gjithëpërfshirëse", thotë Grant, "është kundër sigurisë morale".

Grosmani e dinte se romani i tillë nuk mund të botohej kurrë nën Stalinin por, në vitin 1961, pesë vjet pas fjalimit jo shumë sekret të Hrushovit, u ndie si kohë e mirë për ta provuar këtë. Tani ose kurrë. Megjithatë, kur Grosmani e dorëzoi dorëshkrimin, u vizitua nga KGB-ja e cila ia bastisi banesën, duke i konfiskuar tri kopjet e dorëshkrimit. Dikush shkoi në tavolinën e kryeideologut dhe censorit të partisë, Mihail Suslov, i cili thuhet se e thirri Grosmanin në zyrën e vet për t'i treguar se "Jeta dhe fati" ishte aq i rrezikshëm sa nuk mund të botohej "për dy deri në treqind vjet të tjerë" – megjithëse ky citat është vënë në pikëpyetje nga një biograf i Grosmanit, Yuri Bit-Yunan.

Thuhet shpesh se lufta përfshin shtrirje të gjata të mërzisë, të shoqëruara me momentet e tmerrit të plotë. "Jeta dhe fati" është në stilin gazetaresk dhe nuk pati asnjë rast për t'u redaktuar. Kapitull pas kapitulli na jep përvojën e përditshme të jetës në vijën e parë të totalitarizmit. Derisa lexuesi njihet ngadalë me personazhet, pothuajse inkurajohet. Por, në çdo 50 faqe ose më shumë do ta ketë një pasazh që është krejtësisht zemërthyes.

Hrushovi nuk e bëri një hapje të re, por fjalimi i tij kishte ndezur – pa dashje – një qiri në errësirë, që digej aq sa për të ekzistuar "Jeta dhe fati". Grosmani i kaloi vitet e fundit të jetës së tij në një gjendje të depresionit të tmerrshëm, duke u thënë miqve se libri i tij është "arrestuar". Në vitin 1964 vdiq me librin prapa grilave. Por, një dekadë më vonë, një kopje do të dalë si kontrabandë nga BRSS-ja, në mikrofilm, dhe në vitin 1988, nën politikën e Glasnostit të Mihail Gorbaçovit, rusët dhe ukrainasit më në fund lejohen ta mbajnë në duar kryeveprën e Grosmanit. Disi, e vërteta shpesh duket se e gjen një mënyrë për të shpëtuar nga kthetrat e regjimeve totalitare. E njëjta gjë rrallë mund të thuhet për ata që thonë të vërtetën. /Përkthyer: Agron Shala - Telegraf/



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Arsenali do t'i ofrojë kontratë të re Granit Xhakës

LONDËR, 14 TETOR - Granit Xhaka është duke kaluar nëpër një formë fantastike tek Arsenali këtë sezon.

Sipas medieve britanike, Xhakës do t'i ofrohet kontratë e re, pasi ajo aktuale i përfundon në

fund të sezonit të ardhshëm. Xhakës do t'i ofrohet kontrata pas përfundimit të Kupës së

Botës. "Topçinjtë", pas nëntë xhirove, renditen në vendin e parë me 24 pikë.



Çeku: Do të ndërtohen shtatë palestra të xhudos në Kosovë

PRISHTINË, 14 TETOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Hajrulla Çeku, ka folur për programin e xhudos që është miratuar nga qeveria. "Në mbledhjen e saj të 99 qeveria e miratoi vendimin për programin 'Kosova shtet i xhudos', që është një kornizë strategjike e veprimit për pesë vjetët e ardhshme në vlerë prej 12 milionë eurosh. Programi 'Kosova shtet i xhudos' u shërben qëllimeve strategjike të institucioneve shtetërore të Kosovës, pra është përtej sportit. Duke e zhvilluar tutje sportin e xhudos, synon të ndikojë në mirëqenie të rritur shoqërore në shëndet publik dhe në promovimin ndërkombëtar të shtetit të Kosovës", ka thënë Çeku në foltoren e Kuvendit. Çeku i ka përmendur sërish pikat e

këtij programi si dhe ka folur për rezultatet konkrete që i synojnë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se parashihen të ndërtohen shtatë palestra të xhudos në Kosovë. "Çfarë konkretisht përmban programi 'Kosova shtet i xhudos' janë gjashtë pika: infrastruktura e përmirësuar fizike, fuqizimi i kapaciteteve trajnuese, masivizimi i sportit të xhudos, mbështetje për trajnerët dhe sportistët elitare, organizimi i ngjarjeve ndërkombëtare sportive në vendin tonë dhe promovimi ndërkombëtar i shtetit të Kosovës. Rezultate konkrete të synuara në kuadër të infrastrukturës janë zgjerimi i Qendrës Nacionale të Xhudos në Pejë dhe ndërtimi i shtatë palestrave të xhudos në shtatë qendrat kryesore urbane të vendit tonë", ka thënë Çeku.



Pranimi i golave në minutat e fundit, problem serioz i Ballkanit në Ligën e Konferencës

PRISHTINË, 14 TETOR - Ballkani të enjten është mposhtur me përmbysje nga Sivasspori në kuadër të xhiros së katërt të fazës së grupeve në Ligën e Konferencës. Ekipi nga Suhareka ishte duke avancuar 1:0 deri në minutën 72-të, por i ka humbur tri pikët në fund të ndeshjes. Fillimisht Arslan ka barazuar 1:1 në minutën e 72-të, para se Angielski ta shënonte golin e fitores në minutën e 81-të. E pranimi i golave në 20 minutat e fundit në Ligën e Konferencës është shndërruar në problem serioz për kampionin e Kosovës. Nga katër ndeshjet e zhvilluara deri më tani, në tri prej tyre ka pranuar gola në 20 minutat e fundit. Fillimisht në ndeshjen e parë në "Fadil Vokrri" ndaj Clujit, Ballkani kishte pranuar golin e barazimit në minutën e parë të kohës shtesë.



Në Çeki ndaj Slavia Pragës të pesë golat ishin shënuar në pjesën e parë. Në Turqi ndaj Sivassporit, Ballkani kishte pësuar gol në minutën e 75-të dhe në minutën e parë shtesë, por që arriti të fitojë sërish.

Edhe të enjten në "Fadil Vokrri" Ballkani ka pësuar gola në 20 minutat e fundit të ndeshjes. Në nëntë golat e pranuar, pesë prej tyre kanë ardhur pas minutës së 70-të, ndërsa Ballkani ka mbrojtjen e katërt më të dobët nga të gjitha ekipet pjesëmarrëse në Ligën e Konferencës.

Mbrëmë pas ndeshjes, edhe trajneri i Ballkanit, Ilir Daja, e ka përmendur orarin e ngjeshur dhe lodhjen fizike të lojtarëve si një faktor kyç të rezultatit.

Ballkanit i kanë mbetur edhe dy ndeshje në Ligën e Konferencës. Nëse i fiton të dyja, do të kualifikohet në fazën tjetër.

Bayern Munichu ofron 100 milionë euro për Harry Kanen

BAYERN, 14 TETOR - Bayern Munichu është gati për një investim maksimal për të rrëmbyer Harry Kanen nga Tottenhami, të cilit i skadon

kontrata në vitin 2024. Sipas "The Sun", Kane është i përqendruar te Tottenhami, por Bayerni në verë do të vendosë në tavolinë rreth

100 milionë euro. Oferta që vjen një vit para skadimit të kontratës. Kujtojmë se Manchester City e ka kërkuar me ngulm anglezin, por ky i

fundit zgjodhi që karrierën ta vazhdojë te Spursi. Mbetet të shihet nëse Kane do të tundohet për të luajtur në Bundesligë.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1502 /1
Dt:14.10.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendër e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkoll a	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
QK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një mesimdhënës/e për lëndët e Elektroteknikës me 10 orë mesimore	Deri më 31.08.2023
QK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një instruktor/e për lëndët e Shkencave kompjuterike dizajn softueri	Deri më 31.08.2023
QK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një mesimdhënës/e për lëndën e Gjuhës Angleze me 20 orë mesimore	(zëvendësim i mesimdhënës es në pushim të lehonisë)
QK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një (1) Punëtor teknik me normë të plotë	

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mesimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mesimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mesimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mesimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mesim dhe procese mesimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mesimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;

- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mesimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën punëtor teknik

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit;
- Ndihmon stafin për rregullimin e orendive të shkollës;
- Ndihmon menaxhmentin/personelin mesimdhënës të shkollës për realizimin e punëve teknike;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore.
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe detyra shtese të cilat i ndan drejtori i shkollës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Kandidati duhet të ketë Shkollën e mesme,
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe
- Shkallë të lartë integriteti,

Aftësitë shtesë

- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm për institucionin,
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe synimeve të stafit drejtues si dhe personelit të Shkollës.

Paga: koef 4

Kontrata: Kohëzgjatja e periudhës provuese është gjashtë (6) muaj

Orari: 40 orë pune në javë

Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren .
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
- Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "F-MAX" SH.P.K. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810195083 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit, Isuf Rexhaj nr: 044-234-933. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "F-MAX" D.O.O. Pristin, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810195083 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije, Isuf Rexhaj nr: 044-234-933, Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "F-MAX" L.L.C. Pristin, has come to the decision to quit its business: 810195083 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process Isuf Rexhaj nr: 044-234-933. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr.1503/1

Datë:14.10.2022

NJOFTIM

ANULOHEM konkursi për pozitat:

- 1 (një) Një mësimdhënës/e për lëndët Gjuhës Gjermane në Qendren e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren sipas konkursit të shpallur me datë 21.09.2022, me nr. 1374/1.
- 1 (një) Një Instruktor/e për lëndët Dizajnit të metaleve në Qendren e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren sipas konkursit të shpallur me datë 21.09.2022, me nr. 1374/1.

Nga pjesëmarrësit në konkurs kërkojmë mirëkuptim.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agnesa Jakupi shpall te pavlefshme dëftesat enkl VI - IX shfmu " Abdyl Frasher " Prizren.

- Saranda Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Shpenzim Bytyci shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L